



### VENDIM

Nr.56 Datë 23.04.2015

### PËR

## FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENSIMIT TË SHOQËRISË “NISHOVA ENERGY” SH.P.K., NË AKTIVITETIN E TREGËTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE.

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 gërma “a”; 9 dhe 13 pika 1, gërma “d” të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “g”; 5 pika 1 gërma “g”; 8 dhe 13 dhe 14 pika 1 të “Rregullores për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesëshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 108, datë 09.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 23.04.2015, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “NISHOVA ENERGY” sh.p.k. si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për liçensimin në aktivitetin e tregëtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

### Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “NISHOVA ENERGY” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të plotë/ të pjesëshëm dhe Rinovimit të Liçensave” si më poshtë:

### Për dokumentacionin e përgjithshëm:

**Neni 9, pika 1 *Formati i aplikimit*** është plotësuar në mënyrë korrekte.

**Neni 9, pika 2 *Dokumentacioni juridik, administrator dhe pronesor*** është i plotësuar pjesërisht.

**Neni 9, pika 3 *Dokumentacioni financiar dhe fiskal*** është i plotësuar pjesërisht.

**Neni 9, pika 4/10, germa “a” e paplotesuar**

**Neni 9, pika 4/10, germa b e paplotesuar**

**Neni 9, pika 4/10, germa c, plotesuar**

Për dokumentacionet e munguara, do të njoftohet subjekti që në bazë të “*Rregullores për Proçedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/të Pjesshem dhe Rinovimit të Licensave*”, neni 10, pika 10 dhe neni 11, pika 1, ti paraqese keto ne ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Fillimin e proçedurave për liçensimin e shoqërisë “**NISHOVA ENERGY**” shpk, në aktivitetin e Tregëtimit të Energjisë Elektrike.
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË



Votimi i Bordit të Komisionerëve

VENDIM

Nr.56 Datë 23.04.2015

PËR

FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENSIMIT TË SHOQËRISË “NISHOVA ENERGY” SH.P.K., NË AKTIVITETIN E TREGËTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE.

Anëtarët e Bordit

Pro

Kundër

Petrit Ahmeti

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Adriatik Bego

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Abaz Aliko

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Entela Shehaj

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Maksim Shuli

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_